



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT**  
**DHE KONTROLLIT TË PASURIVE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**INSTITUTI I STATISTIKAVE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

**MEMORANDUM BASHKËPUNIMI**

**Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive (ILDKP)** në mbështetje të ligjit nr.9049, date 10.4.2003 “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” nenit 17, pika “b”, mbledh të dhëna, kryen hetime dhe kërkime administrative rreth deklarimeve të personave që kanë detyrimin për deklarim, sipas këtij ligji, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative;

**Instituti i Statistikave (INSTAT)** në mbështetje të ligjit nr.9180, datë 5.2.2004 “Për Statistikat Zyrtare” neni 8 pika "k" "duhet të hartojë, të negociojë e të nënshkruajë memorandume mirëkuptimi...me mbajtësit e të dhënave administrative, që janë përdorur në nxjerrjen e programit, duke përfshirë organizimet e punës dhe detyrimet dypalëshe".

Përsa më sipër, palët bien dakort të respektojnë qëllimin e këtij Memorandumi Bashkëpunimi si më poshtë:

**Neni 1**  
**Qëllimi**

- Realizimi i bashkëpunimit të ndërsjelltë dhe të vazhdueshëm ndërmjet dy palëve në shkëmbimin e informacionit dhe të dhënave të tjera të nevojshme, në përmbushje të detyrimeve ligjore reciproke.

- Koordinimi dhe mbledhja e të dhënave statistikore, parashikuar ne ligjin nr.9180, datë 5.2.2004 “Për Statistikat Zyrtare”, që do t’i shërbejnë ILDKP-së në drejtim të përmbushjes së detyrave, në zbatim të ligjit Nr.9049, date 10.4.2003 “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike dhe Ligjit

nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

## **Neni 2 Objekti**

- Palët angazhohen për bashkëpunim konkret në realizim të qëllimit të këtij Memorandumi, në frymën e nenit 26 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”.
- Palët do të bashkëpunojnë në shkëmbimin e informacionit, duke respektuar parimin e konfidencialitetit për të dhënat e mbledhura në përputhje me nenin 15 të ligjit nr. 9180, datë 5.2.2004 “Për Statistikat Zyrtare”.
- Bazuar në kërkesat reciproke, palët përkatësisht do të shkëmbejnë informacione të disponueshme që mund të kenë të bëjnë me të dhëna statistikore që shërbejnë në përmbushjen e detyrime ligjore të ILDKP-së.
- ILDKP-ja angazhohet nga ana e saj të vërë në dispozicion të INSTAT-it, informacione apo të dhëna të mbledhura të përpunuara dhe ruajtura, që mund të shërbejnë për nxjerrjen e statistikave zyrtare.

## **Neni 3 Komunikimi**

Palët do të caktojnë person kontakti që do të jenë përgjegjës për zbatimin e Memorandumit. Në rastet e shmangies nga procedurat e përcaktuara në këtë Memorandum, palët do të merren vesh për procedura të pranueshme komunikimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## **Neni 4 Ndryshime**

Memorandumi mund të ndryshohet vetëm me miratimin e ndërsjelltë me shkrim të palëve.

## **Neni 5 Përfundimi i Memorandumit**

Memorandumi mund të përfundojë në çdo kohë. Përfundimi do të hyjë në fuqi me marrjen e njoftimit me shkrim nga Pala tjetër. Deri në përfundimin e këtij Memorandumi, palët do t’u përmbahen termave dhe kushteve që rrjedhin nga ky Memorandum, përsa i përket informacionit dhe dokumentave të shkëmbyera përpara datës së përfundimit të tij.

**Neni 6**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij nga përfaqësuesit e palëve. Memorandumi, hartohet në gjuhën shqipe, përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe dy të tjera në Institutin e Statistikave.

Ky Memorandum Bashkëpunimi u nënshkrua sot, në datë 13 Mars 2008.

**PËR INSPEKTORATIN E LARTË  
DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT  
TË PASURIVE**

**PËR INSTITUTIN E STATISTIKAVE**

**INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM  
FATMIRA LASKA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM  
INES NURJA**